



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE  
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 8/1 Prot

Tiranë më, 22/01/2019

**Njoftim**

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve pranë ASA-së njofton:

1. Hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve përfaqësues të studentëve, të cilët do t'i propozohen Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila më pas do zgjedhë një prej këtyre kandidaturave të propozuara, si përfaqësues të saj në Bordin e Administrimit të ASA-së.
  2. Ftohen kandidatët që të vetëpropozohen.
  3. Dorëzimi i kërkesës bëhet **VETËM** pranë **KIZ** në zyrën e sekretares **Marsela Meta** në godinën qendrore të Akademisë së Studimeve Albanologjike, Sheshi "Nënë Tereza" Nr. 3.
  4. Kriteret që duhet të plotësojë një student për t'u emëruar anëtar i bordit janë si më poshtë vijon:
    - a. Të ketë integritet etik dhe profesional;
    - b. Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;
    - c. Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë;
    - d. Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave.
  5. Dokumentacion i nevojshëm për kandidim është:
    - a. Kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë, dhe shprehjen e vullnetit për kandidim.
    - b. Kopje të dokumentit të identifikimit;
    - c. Vërtetim që provon se është student me kohë të plotë në institucionin e arsimit të lartë publik përkatës;
    - d. Propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore;
    - e. Deklaratë që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
    - f. Deklaratë që nuk ka konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore për parandalimin e konfliktit të interesave
- a. Afati i dorëzimit të aplikimeve nga kandidatët është nga data **28.01.2019-01.02.2019, ora 16.00.**

**KRYETAR**

Sali Kadri

